



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KOMISIONI QENDROR I ZGJEDHJEVE

KOMISIONERI SHTETËROR I ZGJEDHJEVE

Data: 30 Janar 2021

Nr: 18

V E N D I M

P Ë R

**SHQYRTIMIN ADMINISTRATIV TË DENONCIMIT NR. 460 DATË 06.01.2021 PËR
SHKELJE TË PARASHIKUAR NË VENDIMIN NR. 9, DATË 24.12.2020 TË
KOMISIONIT RREGULLATOR NË KOMISIONIN QENDROR TË ZGJEDHJEVE
NDAJ Z. ALKET HYSENI**

Në mbështetje të neneve 19, pikat 1, shkronja “n”, e 2, dhe 91, 92, të ligjit nr. 10019, datë 29.12.2008, “Kodi Zgjedhor i Republikës së Shqipërisë”, të ndryshuar, neneve 20, 60 dhe vijues të ligjit nr. 44/2015 “Kodi i Procedurave Administrative i Republikës së Shqipërisë”, vendimit nr. 9, datë 24.12.2020, të Komisionit Rregullator në Komisionin Qendror të Zgjedhjeve,

V Ë R E J:

Në Komisionin Qendror të Zgjedhjeve, me datë 6 Janar 2021 është raportuar një denoncim nga subjekti politik Lëvizja Socialiste për Integrim (LSI), në ndërfaqen e “Aktiviteteve të Ndaluara”, në rubrikën “Kallëzo”, për veprimtaritë e deputetit të Partisë Socialiste, Qarku Vlorë z. Alket Hysenaj, i cili në datën 6 janar 2020 ka thirrur në takim drejtues të Policisë së Shtetit Sarandë.

Sipas denoncimit më datë 06.01.2021, me numër identifikimi të gjeneruar nga sistemi ID NR. 460 ora 20:21, pretendohet se: “Më datë 6 janar 2021 deputeti A.Hyseni ka thirrur në takim drejtues të policisë së shtetit Sarandë. Zoti Hyseni është deputet, është politikan, është kandidat në zgjedhje dhe drejtues politik i zonës dhe asnjë pikë e legjislacionit shqiptar nuk i jep të drejtë deputetëve të thërrasin në takim, e ti kërkojnë llogari policisë së shtetit. Rasti konkret përbën shkelje të dispozitave ligjore dhe një sinjal negativ për zgjedhjet dhe rolin e Policisë në to, ndaj është në interesin e vetë KQZ-së të reagojë përdistancimin nga praktika të tilla dhe ndalimin e tyre në të ardhmen.



Data: 30 Janar 2021

Nr. 18

Për shqyrtimin administrativ të denoncimit nr. 406 datë 06.01.2021 për shkelje të parashikuar në vendimin nr. 9, datë 24.12.2020 të Komisionit Rregullator në Komisionin Qendror të Zgjedhjeve ndaj

Si prove e paraqitur është foto e deputetit me disa individë, marre nga faqja në Facebook e deputetit z. Alket Hyseni si dhe lidhja e faqes. Nga klikimi i linkut nuk mundësohet hapja nga faqja ueb dhe rrjedhimisht nuk mundësohet marrja e provave nga burime te hapura te informacionit.

Sipas përcaktimeve të nenit 44 të ligjit nr. 44/2015 “Kodi i Procedurave Administrative i Republikës së Shqipërisë”, Komisioneri Shtetëror i Zgjedhjeve shqyrtoi paraprakisht kërkesat lidhur me kompetencën e organit publik për shqyrtimin e tyre.

Neni 3, paragrafi 2 i Vendimit Nr. 9/2020 “Për rregullat e raportimit të veprimtarive me karakter publik të çdo institucioni publik, e me kapital shtetëror, agjencive, enteve shtetërore, kategoritë e veprimtarive të ndaluara, si dhe monitorimin e veprimtarisë, sjelljes dhe përdorimit të burimeve njerëzore, financiare dhe logjistike të administratës shtetërore para zgjedhjeve” të Komisionit Rregullator ka përcaktuar rrethin e subjekteve të cilët ngarkohen për zbatimin e këtij vendimi sipas përcaktimit të mëposhtëm:

“Kryeministri, administrata e tij, Zëvendëskryeministri, ministri dhe zëvendësministri, administrata e tyre, kryetari i bashkisë zëvendësit dhe administrata e tij, Prefekti dhe administrata e tij, drejtori i përgjithshëm i agjencive apo institucioneve në varësi të Kryeministrit, Këshillit të Ministrave ose Ministrit, drejtori i përgjithshëm, drejtorët e departamenteve, drejtorët e drejtorive dhe administratat respektive, drejtuesit dhe anëtarët e organeve kolegjiale, enteve, bordeve, çdo drejtues i shoqërive tregtare në administrim nga shteti si edhe në çdo ent ku shteti zotëron aksione e kapitale/kuota apo emëron shumicën e organit mbikëqyrës ose të organit administrues, titullari dhe zëvendësit e tij për ndërmarrjet shtetërore, gjatë periudhës kohore 4 (katër) mujore para datës së zgjedhjeve deri në ditën e zgjedhjeve, e kanë të ndaluar të drejtojnë, të marrin pjesë apo të kontribuojnë në çfarëdo formë, në veprimtari publike të ndaluara sipas këtij vendimi”.

Duke qenë se denoncimi i subjekti politik (LSI), lidhet vetëm me deputetin z. Alket Hyseni, theksojmë se deputeti nuk përfshihet në rrethin e subjekteve të përcaktuara në paragrafin 2, të nenit 3, të vendimit nr. 9/2020 të Komisionit Rregullator në Komisionin Qendror të Zgjedhjeve. Ne lidhje me pretendimin e denoncuesit se z. Alket Hyseni është kandidat për deputet, referuar dispozitave të nenit 67 të Kodit Zgjedhor, listat e kandidateve për deputet dorëzohen në KQZ jo më vonë se 50 dite para datës së zgjedhjeve. Aktualisht KQZ nuk ka marre asnjë vendim për regjistrimin e listave shumëmemërore të kandidateve për ndonjë zone zgjedhore.

Në këto kushte Komisioneri Shtetëror i Zgjedhjeve, nuk mund të fillojë një procedurë administrative të kërkuar nga denoncuesi.



PËR KËTO ARSYE:

Në mbështetje të neneve 19, pikat 1, shkronja “n”, e 2, dhe 91, 92, të ligjit nr. 10019, datë 29.12.2008, “Kodi Zgjedhor i Republikës së Shqipërisë”, të ndryshuar, nenit 20 dhe vijues dhe nenit 60 dhe vijues të ligjit nr. 44/2015 “Kodi i Procedurave Administrative i Republikës së Shqipërisë”, Vendimit nr. 9, datë 24.12.2020, të Komisionit Rregullator në Komisionin Qendror të Zgjedhjeve

V E N D O S:

1. Mosfillimin e procedurës administrative, për shkak të mungesës së fakteve dhe rrethanave që përfshihen në fushën e zbatimit, të ligjit nr. 10019 datë 29.12.2008 “Kodi Zgjedhor i Republikës së Shqipërisë”, i ndryshuar dhe vendimit nr. 09/2020 të Komisionit Rregullator në Komisionin Qendror të Zgjedhjeve.
2. Rezultatet e këtij vendimi i njoftohen me postë elektronike denoncuesit.

Komisioneri Shtetëror i Zgjedhjeve

Illirjan CELIBASHI

